

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 15.06.2022, në bazë të nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), nenit 63 paragrafi (1) dhe (2), nenit 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi Kërkesën për miratimin e qëndrimit parimor dhe të mendimit juridik parimor, të parashtruar nga Shoqëria e avokatëve Staninov dhe Kolevski nga S., nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Iniciativa e parashtruar nga Shoqëria e avokatëve Staninov dhe Kolevski nga S., evidentuar nën 03 Su-nr.123/22 të datës 15.02.2022, me propozim që Seanca e përgjithshme të miratojë qëndrim parimor dhe mendim juridik parimor për çështjet juridike: - “A ka të drejtë i njëjti gjyqtar që ka vepruar në një lëndë të përmbaaruar para gjykatës themelore të veprojë përsëri në të njëjtën lëndë të përmbaaruar, - A guxohet që lëndët të shpërndahen me dorë në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për gjykatat, - vallë një dokument i anuluar sipas ligjeve dhe akteve nënligjore shkakton veprim juridik.”, NUK MIRATOHET.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06 ... nr.96/19), Seanca e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 15.06.2022 shqyrtoi mbi Inicativën për miratimin e qëndrimit parimor dhe të mendimit juridik parimor 03Su. nr.123/22 të datës 15.02.2022, të parashtruar nga Shoqëria e avokatëve Staninov dhe Kolevski nga S., ndërsa lidhur me çështjet e parashtruara juridike - “A ka të drejtë i njëjti gjyqtar që ka vepruar në një lëndë të përmbaaruar para gjykatës themelore të veprojë përsëri në të njëjtën lëndë të përmbaaruar, - A guxohet që lëndët të shpërndahen me dorë në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për gjykatat, - vallë një dokument i anuluar sipas ligjeve dhe akteve nënligjore shkakton veprim juridik.

Në iniciativë theksohen shkelje të shumë dispozitave të Ligjeve të ndryshme në jurisprudencë, si Ligji për procedurë kontestimore, Ligji për shpërndarjen automatike të lëndëve, Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe Ligji për përmbaarim, në arsyetimin e të njëjtës theksohet se lëndët përmbaaruese ndahen me dorë

dhe e njëjta lëndë i ndahet vetëm një gjyqtari, shumë pak gjyqtarë janë të sistemuar për lëndët përmbarese, nuk pajtohet me dispozitat e Ligjit për përmbarrim më saktë me nenin 190 nga i njëjti ligj se i mbron vetëm të pasurit.

Ndaj iniciativës (kërkesës) është dorëzuar një aktgjykim nr. 52 TS -6/20 dhe shkresa tjera dhe kërkesa me Gjykatën Themelore Civile Shkup. – Propozim për ndërprerjen e përmbarrimit dhe Propozim për shkarkimin e një klauzole për përmbarrim te noteri, pa treguar vendime ose rezultate nga ato kërkesa.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke vendosur për kërkesën e theksuar, nxori Konkluzion me të cilin konsideron se nuk rezulton nevoja që të miratohet qëndrim parimor (mendim), për arsye se nuk ka zbatim të pabarabartë të ligjit dhe nuk ka vendime të ndryshme për sigurimin e barazisë në zbatimin e të drejtës.

Gjykata Supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Seanca e përgjithshme